



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 9 NËNTOR 2023, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**  
(Seanca filloi në orën 10:00)

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 12.10.2023 dhe 2.11.2023 (neni 44, pika 2, i Rregullores).

2. Njoftime (neni 44, pika 3, i Rregullores)

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit” (në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim).

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar” (në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

5. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

7. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” *(në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe nenit 81, pika 2, të Kushtetutës si dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

8. Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” *(në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe nenit 81, pika 2, të Kushtetutës si dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

9. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” *(në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe nenit 81, pika 2, të Kushtetutës si dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)*

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

*(Zhurmë në sallë)*

E përsëris edhe një herë: kjo situatë në Kuvendin e Shqipërisë është e papranueshme. Nuk janë as karriget dhe as godina...

*(Zhurmë në sallë)*

Fillojmë me rendin e ditës:

Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 12.10.2023 dhe 02.11.2023.

Njoftime

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare...”

*(Zhurmë në sallë)*

Zoti Korreshi, ju tërheq vërejtje!

*(Zhurmë në sallë)*

Zoti Korreshi...

*(Zhurmë në sallë)*

Zoti Korreshi, në bazë të nenit 65, ju përjashtoj nga seanca për ditën e sotme.

*(Zhurmë në sallë)*

Lironi sallën!

Garda, ju lutem, hiqini flakadanët!

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik””.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Procesverbalet i keni marrë në rrugë elektronike. A ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohen.

*(Zhurmë në sallë)*

Ju njoftoj se në Kuvend gjatë kësaj jave janë depozituar: një projektligj nga Këshilli i Ministrave; një projektligj, nismë e një deputeti, dhe një interpelancë urgjente nga deputeti Kreshnik Çollaku, e cila është depozituar ditën e martë, në orën 15:40.

*(Zhurmë në sallë)*

Në lidhje me interpelancën urgjente, ju sqaroj se, në bazë të nenit 97 të Rregullores, kërkesa për interpelancë duhet firmosur nga 7 deputetë dhe duhet të paraqitet para orës 14:00.

*(Zhurmë në sallë)*

Fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit””.

Zoti Mete, fjala për ju.

*(Zhurmë në sallë)*

**Ervin Mete** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kjo është një kredi me Bankën Botërore, në kuadër të Agjendës së Gjelbër dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në kuadër të programit “Aftësia ripërtëritëse dhe zhvillimi i gjelbër”, që mundëson financimin e një kredie në formën e mbështetjes buxhetore nga Banka Botërore prej 110,8 milionë eurosh, forcimin e qëndrueshëm të disa sektorëve, si: të tregut të energjisë, të energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e efekteve që sjellin ndryshimet klimaterike.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Vazhdojmë me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

*(Zhurmë në sallë)*

Zoti Petrit Vasili?

*(Zhurmë në sallë)*

Nuk e merr fjalën.

*(Zhurmë në sallë)*

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar”.

Fjala për zonjën Jorida Tabaku, si propozuese.

*(Zhurmë në sallë)*

Fjalën e ka zonja Enslemvera Zake, si relatore.

*(Zhurmë në sallë)*

**Enslemvera Zake** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Lidhur me nismën e zonjës Jorida Tabaku për taksat kombëtare, ne e kemi diskutuar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Arsyetja pse nuk u miratua dhe është rrëzuar kjo nismë

lidhet me faktin se në Parlamentin e Shqipërisë është një projektligj, i cili tashmë është hartuar dhe është në fazën e konsultimit me publikun; një pjesë e rekomandimeve dhe e propozimeve të zonjës Tabaku janë përfshirë në këtë ligj të ri. Ky projektligj do të vijë shumë shpejt në Parlament, ndaj arsyeja e vetme për të cilën nisma është rrëzuar, është për të mos krijuar konfuzion mes ligjit të hartuar më parë dhe ligjit që do të miratojmë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik””.

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Jo.

Fjala për zonjën Antoneta Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në cilësinë e relatores së këtij projektligji, e vlerësoj kontributin e koleges Tabaku për paraqitjen e propozimeve konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e procedurave të prokurimit publik në drejtëm të transparencës, rritjes së konkurrenshëmërisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në luftën kundër korrupsionit. Qeveria e ka përfshirë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”” në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2023, si dhe në Planin Kombëtar të Integritit Europian për vitin 2023, me afat tremujorin e katërt të vitit 2023. Këtë projektligj mund ta aksesojmë në faqen e konsultimit publik. Pra, duke pasur parasysh që grupi i punës ka avancuar me rishikimin e legjislacionit të prokurimit publik, me qëllim amendimin e problematikave të dala gjatë zbatimit të ligjit nr. 162/2020 në periudhën 2-vjeçare, si dhe përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Europian, me ekspertizën e partnerëve ndërkombëtarë dhe të SIGMA-s, kërkoj që ta rrëzojmë propozimin e deputetes Tabaku.

Nga ana tjetër, komisioni i kërkon grupit të punës që, nëse gjen elemente të përbashkëta të politikave të ligjit të ri me parashkrimet e nismës së koleges Tabaku, t’i marrin ato në konsideratë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Fjalën e ka zonja Kryemadhi. Nuk është.

(Zhurmë në sallë)

Fjalën e ka zonja Ermonela Felaj.

(Zhurmë në sallë)

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, janë tri nisma për Kodin Penal, që janë bërë nga deputetë të opozitës. Unë do të mbaj një fjalë për të tria nismat, të cilat, siç e përmenda, janë propozuar nga deputetë të opozitës, por, kur propozuesit nuk e marrin guximin dhe mundimin që t’i mbrojnë ato, unë i ftoj kolegët deputetë të mazhorancës që t’i rrëzojnë propozimet, sepse edhe deputet, edhe punëtor ngarkim-shkarkimi, edhe jurist për të ndryshuar Kodin Penal nuk mund të jesh.

Faleminderit!

(Zhurmë në sallë)

**Lindita Nikolla** – Zoti Balla ka kërkuar fjalën.

(Zhurmë në sallë)

**Taulant Balla** – Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një seancë e veçantë, sepse pjesa më e madhe e projektligjeve janë propozime të deputetëve të opozitës, ndaj do të ishte e udhës që deputetët e opozitës ta merrnin fjalën dhe të shpjegonin qëllimet për të cilat i kanë marrë këto iniciativa ligjore. Në fakt, deputeti ligjvënien dhe propozimin e ligjeve e ka detyrën e tij primare, por kjo pamje tregon se këtë punë nuk e keni marrë kurrë seriozisht. Fakti që nuk pranoni të prezantoni projektligjet që keni propozuar vetë, e përkeqëson marrëdhënien tuaj me njerëzit, sepse, në fund të fundit, secili prej jush, kush më shumë dhe kush më pak (se ka edhe deputetë që kanë ardhur me 364 vota në këtë sallë), e ka detyrë ta ushtrojë mandatin që i ka ngarkuar populli me përgjegjshmëri.

Thirrja ime ndaj pjesës më të madhe të deputetëve, që janë në krahun e djathtë të kësaj sale, është: ju lutem, mos u keqpërdorni nga interesi dhe halli personal i një njeriu të vetëm. Ky njeri e ka marrë peng Partinë Demokratike prej 33 vjetësh. Kjo që ndodh sot këtu, nuk ka të bëjë fare as me parlamentarizmin, as me kërkesat e opozitës. Meqenëse kërkonte komisione hetimore parlamentare, përse nuk mblidhni 28 firma dhe ankesën tuaj ta çoni në Gjykatë Kushtetuese? A i keni ezauruar të gjitha instrumentet ligjore për të shkuar në Gjykatën Kushtetuese, apo keni harruar

që Gjykata Kushtetuese jua ka rrëzuar kërkesat?! Shkoni dhe çojeni kërkesën në Gjykatën Kushtetuese dhe, në rast se Gjykata Kushtetuese do të vendosë se ju është mohuar e drejta, atëherë jam plotësisht dakord. Por, mos harroni asnjëherë se detyra e Kuvendit është: së pari, të zbatojë Kushtetutën; së dyti, të zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ne nuk i vendosim kurrë në dyshim vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Neve na ka ngarkuar Gjykata Kushtetuese që ta rishikojmë ligjin për komisionet hetimore. Prandaj është e rëndë që deputetët e opozitës të përdoren për interesin personal të një individi.

Unë nuk kam asnjë keqardhje për individin, dhe besoj se për këtë jemi të qartë. Keqardhja ime më e madhe është imazhi i keq që ju doni të krijoni për Kuvendin e Shqipërisë.

Shqipëria sot e mbylli tetorin me 9 milionë vizitorë turistë dhe deri më 31 dhjetor presim që Shqipëria të ketë plot 10 milionë turistë.

Ai njeri ka 33 vjet që është munduar ta dëmtojë, sa të ketë mundësi, imazhin e Shqipërisë, por ta harroni ju se Shqipëria mund të kthehet më mbrapa. Shqipëria e ka marrë vendimin e saj: vetëm përpara, nuk kthehet më mbrapa. Përpjekja juaj për ta dëmtuar imazhin e Shqipërisë është një përpjekje e dështuar.

Për ta përmbyllur, dua t'u kujtoj disa prej deputetëve që u përfshinë në akte të paligjshme, se vendosja e flakadanëve, e lëndëve kimike në salla të mbyllura dhe të hapura, nëse doni, është një vepër penale dhe...

*(Zhurmë në sallë)*

Mos fol ti që shkoje e u bëje presion ushtarakëve për të firmosur! Ti mos fol!

*(Zhurmë në sallë)*

Ti duhet të jesh në bankën e të akuzuarve, por përfiton për shkak të parashkrimit...

*(Zhurmë në sallë)*

Ti që je përdorur për t'u bërë presion ushtarakëve, je i fundit. Natyrshëm, siç të ka përdorur, ashtu vazhdon të të përdorë. Unë nuk flas për ty, unë flas për deputetë të ndershëm, të cilët sot po keqpërdoren për hallin e atij dhe hallin tënd...

*(Zhurmë në sallë)*

Prandaj, deputetë, mos përdorni lëndë kimike në sallën e Kuvendit! Mos u përdorni si mish për top për hallin e një personi të vetëm!

Faleminderit!

*(Zhurmë në sallë)*

**Lindita Nikolla** – Vazhdojmë me projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Fjalën e ka zonja Xhixho. Nuk është.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Fjalën e ka zonja Ina Zhupa.

*(Zhurmë në sallë)*

Këtu mbyllet debati për çështjet e sotme.

Zonja Felaj kërkon fjalën.

*(Zhurmë në sallë)*

Zonja Felaj, fjala për ju.

**Ermonela Felaj** – Vetë qëndrimi që jeni duke mbajtur në këtë sallë, ju vë në kontradiktë të plotë me atë çfarë i thoni publikut. Ju keni thënë kaq herë: “Kemi bërë nisma dhe mazhoranca nuk i diskuton”, ndërkohë që të tria nismat mazhoranca i ka diskutuar një për një. Kur janë shtyrë, janë shtyrë, sepse nuk keni qenë në komisione. Edhe sot në këtë sallë nuk po e merrni mundimin t'i paraqisni këto nisma. A e dini pse?! Sepse nismat tuaja janë thjesht për t'i shërbyer një njeriu të vetëm: Sali Berishës, dhe ju po shkoni si dele qorre pas një njeriu të vetëm.

Të rrëzohen, Kryetare, të tria nismat!

**Lindita Nikolla** – Kalojmë në procesin e votimit. Duke iu referuar nenit 58, votimi do të bëhet me kartonë dhe me ngritje të dorës.

Hapet votimi për prezencën.

*(Zhurmë në sallë)*

75 deputetë.

Vazhdojmë me votimin e akteve.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit””.

Hapet votimi në parim.

*(Zhurmë në sallë)*

75 vota pro.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

*(Zhurmë në sallë)*

Hapet votimi në tërësi.  
75 vota pro.  
Projektligji miratohet në tërësi.  
Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

Hapet votimi në parim.  
(*Zhurme në sallë*)  
Nuk ka vota pro.  
75 vota kundër.  
Nuk miratohet në parim.  
Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar”.

Hapet votimi në parim.  
Nuk ka vota pro.  
75 vota kundër.  
Projektligji nuk miratohet.  
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik””.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash.  
Hapet votimi në parim.

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**

Nuk ka vota pro.  
75 vota kundër.  
Projektligji nuk miratohet.  
Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Nuk ka vota pro.  
75 vota kundër.  
Projektligji nuk miratohet.  
Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

(*Zhurme në sallë*)  
75 vota kundër.  
Projektligji nuk miratohet.  
Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

75 vota kundër.  
Projektligji nuk miratohet.  
Seanca mbyllet.  
Seanca e radhës do t’ju njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 10:30)

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**